

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE  
PROCES VERBAL & VENDIME  
qarkulluese, 15 Korrik 2025



Në mbledhje morën pjesë këta pjesëmarrës:

| <u>Emri i pjesëmarrësve</u>                                                                                                      | <u>Përqindja</u>        |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
| 1. Z. Kadri Morinaj, përfaqësues i<br>EUROSIG SH.A                                                                               | 99.16%                  |
| 2. Z. Gazmen Neza, përfaqësues i<br>EURO-ALBA-EA Sh.p.k.                                                                         | 0.03%                   |
| 3. Z. Kadri Morinaj                                                                                                              | 0.03%                   |
|                                                                                                                                  | <u>Total:</u><br>99.22% |
| 4. <u>Pjesëmarrës të tjerë:</u><br>Z. Orfea Dhuci, Drejtor i Përgjithshëm i BBSH<br>Z. Jemin Gjana, Kryetar i Këshillit Drejtues |                         |

Sekretare e Mbledhjes:

Znj. Enxhi Karalliu, Drejtor Dep. i Përputhshmërisë

Pjesëmarrja në mbledhje nga aksionerët dhe përfaqësuesit e tyre u bë online (qarkulluese) dhe përfaqësoi 99.22% të totalit të kapitalit të paguar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Identifikimi i aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre është siguruar dhe garantuar në përputhje me ligjin.

Mbledhja është vazhdim i mbledhjes së mbajtur më datë 27.06.2025 për pikën III të saj, dhe u thirr për të diskutuar si në vijim:

RENDI I DITËS:

- I. Zmadhimi i kapitalit në BBSH;
- II. Çështje të tjera.

EUROSIG SH.A

Përfaqësuar nga  
Kadri Morinaj

Sekretare  
Enxhi Karalliu

AKSIONARËT

EURO-ALBA-EA Sh.p.k.

Përfaqësuar nga  
Gazmen Neza

Kadri Morinaj



BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONEREVE  
PROCES VERBAL & VENDIME  
qarkulluese, 15 Korrik 2025



**VENDIM NR. 1**

**Zmadhimi i kapitalit në BBSH**

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë u mbledh rregullisht në këtë mbledhje për të vazhduar diskutimin dhe vendimmarrjen në lidhje me pikën III të rendit të ditës së mbledhjes datë 27 Qershor 2025 në lidhje me zmadhimin e kapitalit në BBSH.

Në mbledhjen e datës 24 Prill 2025, Asambleja e Përgjithshme mori Vendimin Nr. 6 për "Zmadhimin e kapitalit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me fonde likuide në shumën 600,000,026.96 Lekë duke emetuar 349,213 aksione të reja me vlerë nominale 1,718.15 Lekë për aksion. Këto aksione të reja i'u ofruan të gjithë aksionerëve në mënyrë proporcionale, sipas Statutit të bankës dhe dispozitave të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Pas përfundimit të afatit për përgjigje për pjesëmarrjen në rritjen e kapitalit, asnjë nga aksionarët ekzistues nuk shprehën vullnetin të marrin pjesë në rritjen e kapitalit dhe nuk e ushtruan të drejtën e tyre preferenciale për nënshkrimin e aksioneve të reja. Kështu, aksionet e reja i'u ofruan palëve të treta sipas procedurës dhe konkretisht shoqërisë EURO-ALBA-EA Sh.p.k, i cili ishte dhe aksionar i tërthortë i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë deri më datë 20.06.2025 dhe tashmë është dhe aksionar i drejtpërdrejtë.

Më tej, nisur nga nevojat urgjente për kapital rregullator sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë brenda muajit Korrik 2025, më datë 27 Qershor 2025 Asambleja e Përgjithshme miratoi rritjen e numrit të aksioneve të reja të emetuara duke miratuar shumën e re për zmadhimin e kapitalit prej 1,469,868,026.29 Lekë, nëpërmjet emetimit të 855,495 aksione të reja gjithsej me vlerë nominale 1,718.15 Lekë secili.

Aksionari EURO-ALBA-EA Sh.p.k pranoi të rrisë kapitalin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me shumën e re 1,469,868,026.29 Lekë dhe njoftoi se pagesa për aksionet e reja do të përfundojë brenda muajit Korrik 2025 në mënyrë që të përmbushen kërkesat rregullatore.

Këto vendime u publikuan në faqen zyrtare të bankës në internet: [www.uba.com.al](http://www.uba.com.al) dhe u regjistruan në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në zbatim të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në datën e sotme, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, duke njohur nevojën urgjente edhe për një rritje tjetër të kapitalit të bankës me qëllim që të plotësohen të gjitha kërkesat rregullatore nga Banka e Shqipërisë, shqyrtoi mundësinë e rritjes së mëtejshme të numrit të aksioneve të reja të emetuara edhe me 151,326 aksioneve të reja dhe rrjedhimisht rritjen e shumës të zmadhimit të kapitalit edhe me 260,000,641.67 Lekë. Kështu, nga 349,213 aksione në vlerën 600,000,026.96 Lekë të emetuara sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve datë 24.04.2025, shuma totale e zmadhimit të kapitalit të jetë 1,729,868,667.96 Lekë dhe numri total i aksioneve të reja të jetë 1,006,821.

Asambleja u njoftua se, që prej nisjes së procedurës së rritjes së kapitalit nëpërmjet Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve datë 24.04.2025 dhe pas përfundimit të afatit për përgjigje për pjesëmarrjen në rritjen e kapitalit, asnjë nga aksionarët ekzistues nuk shprehën vullnetin të marrin pjesë në rritjen e kapitalit



BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE  
PROCES VERBAL & VENDIME  
qarkulluese, 15 Korrik 2025



dhe nuk e ushtruan të drejtën e tyre preferenciale për nënshkrimin e aksioneve të reja. Nëse as aksionari EURO-ALBA-EA Sh.p.k, i cili kishte pranuar të marrë pjesë në rritjen e kapitalit me shumën 1,469,868,026.29 Lekë, nuk do të pranojë të marrë pjesë me rritjen e kapitalit edhe për shumën shtesë prej 260,000,641.67 Lekë, aksionet e reja të emetuara do t'i ofrohen palëve të treta të cilët janë të gatshëm të kryejnë pagesën për aksionet e reja brenda muajit Korrik 2025 në mënyrë që të përmbushen kërkesat rregullatore, konkretisht shoqërisë DTU Eurosig Investment Shpk Shkup, shoqëri jo rezidente me të cilën janë zhvilluar negociata paraprake.

Për sa më lart, pasi e diskutoi çështjen në tërësi, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, në vijim të mbledhjes datë 27.06.2025, me shumicë votash të kapitalit aksionar:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shumën shtesë prej 260,000,641.67 Lekë/-(dyqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë Lekë) për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet fondeve likuide, duke emetuar edhe 151,326 aksione të reja me vlerë nominale 1,718.15 Lekë/- (një mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë pikë pesëmbëdhjetë) për aksion.
2. Aksionet e reja do të nënshkruhen kundrejt kontributeve të reja nga palë të treta. Bazuar në pikën 2 të Nenit 174 të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", për aksionet e reja të emetuara të cilat janë shtesë e shumave të miratuara me vendimet e mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve datë 24.04.2025 dhe datë 27.06.2025, të kufizohet afati 20 ditor për ushtrimin e të drejtës së parablerjes nga aksionarët ekzistues, sipas propozimit të paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme nga administratori, ku janë dhënë arsyet për kufizimin e afatit të njoftimit 20 ditor.
3. Ky vendim i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës: [www.uba.com.al](http://www.uba.com.al) dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB): [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), në përputhje me pikën 2 të Nenit 174 të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
4. Ky vendim i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të depozitohet dhe në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
5. Shuma prej 260,000,641.67 Lekë për aksionet e reja që do të nënshkruhen duhet të paguhet brenda muajit Korrik 2025 në llogarinë bankare të ndërmjetme për rritje kapitali, siç do të përcaktohet nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë.
6. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të Bankës për të ndjekur këtë proces, të regjistrojë këtë vendim dhe dokumentet e tjerë në lidhje me të pranë autoriteteve përkatëse për respektimin e procedurave të kërkuara.
7. Pas nënshkrimit të aksioneve të reja nga aksionari apo pala e tretë që do të kryejë zmadhimin e kapitalit, një vendim tjetër do të merret nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Aksionarëve për

BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE  
PROCES VERBAL & VENDIME  
qarkulluese, 15 Korrik 2025



finalizimin e procesit dhe do të miratohen ndryshimet përkatëse në strukturën e kapitalit. Për këtë arsye, kjo mbledhje mbetet e hapur.

AKSIONARËT

**EUROSIG SH.A**  
Përfaqësuar nga  
Kadri Morinaj

**EURO-ALBA-EA Sh.p.k.**  
Përfaqësuar nga  
Gazmen Neza

Kadri Morinaj



Sekretare  
Enxhi Karalliu



BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE  
PROCES VERBAL & VENDIME  
qarkulluese, 15 Korrik 2025



ANEKSI 1

Shuma e zmadhimit të kapitalit

| Aksionerët Ekzistues          | Vlera Nominale për Aksion (Lekë) | Përqindja për Aksionar | Nr. i aksioneve të reja të emetuara | Vlera nominale e aksioneve të reja të emetuara (Lekë) |
|-------------------------------|----------------------------------|------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------------------|
| EUROSIG SHA                   | 1,718.15                         | 99.16%                 |                                     |                                                       |
| EURO-ALBA.EA SHPK             | 1,718.15                         | 0.03%                  |                                     |                                                       |
| Kadri Morinaj                 | 1,718.15                         | 0.03%                  |                                     |                                                       |
| Saudi Brothers Commercial Co. | 1,718.15                         | 0.17%                  |                                     |                                                       |
| Hamed H. Mutabagani           | 1,718.15                         | 0.50%                  |                                     |                                                       |
| Hayder Mohamad Aëad           | 1,718.15                         | 0.07%                  |                                     |                                                       |
| Faisal El Kherei              | 1,718.15                         | 0.04%                  |                                     |                                                       |
| Palë të treta                 | -                                | -                      | 151,326                             | 260,000,641.67 Lekë                                   |
| Total                         |                                  | 100.00%                |                                     |                                                       |

AKSIONARËT

EUROSIG SH.A  
Përfaqësuar nga  
Kadri Morinaj

EURO-ALBA-EA Sh.p.k.  
Përfaqësuar nga  
Gazmen Neza

Kadri Morinaj

Sekretare  
Enxhi Karalliu

Banka e Bashkuar e Shqipërisë



5/6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

Nr. 2001 Prot

Datë 25/06/2025

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE EUROSIG SHA

VENDIM

Nr. 20 dt. 25/06/2025

PËR

PJESËMARRJE NË MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME  
TË BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e mbledhur sot në Tiranë, më datë 25/06/2025, në selinë e shoqërisë "Eurosig" sh.a., me adresë Rruga "Papa Gjon Pali i II-të, Vila nr. 5", Tiranë, në zbatim të neneve 135, 136, 144, 145 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjit Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" të ndryshuar, në përfundim të mbledhjes me unanimitet të plotë,

VENDOSI:

1. Autorizimin e z. Kadri Morinaj për të përfaqësuar dhe për të marrë vendime në emër dhe për llogari të shoqërisë Eurosigs sh.a. në cilësinë e aksionarit, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë që do të zhvillohet më datë 27/06/2025 si dhe në çdo mbledhje në vazhdim të saj, me rend dite:

- I. Shitja e aksioneve nga EUROSIG SHA;
- II. Anullim i aksioneve të papaguara;
- III. Realizimi i zmadhimit të kapitalit në BBSH dhe miratimi i strukturës së re të kapitalit;
- IV. Miratimi i Pasqyrave Financiare të Audituar të BBSH për Fundvitin 2024 të përgatitura sipas Standarteve të SNRF (IFRS-së);
- V. Miratimi i Pasqyrave Financiare të Audituar të BBSH për Fundvitin 2024 të përgatitura sipas "Metodologjisë së Raportimit dhe Permbajtjes së Raportimit Financiar" në zbatim të Ligjit për Bankat (Raportimi i Bankës së Shqipërisë);
- VI. Emërimi i auditorit të jashtëm – ekspert kontabël i autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të Bankës për vitin 2025;
- VII. Çështje të tjera.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:

KADRI MORINAJ

YLLI MERKAJ

XHEVDET MORINA

SHOQËRIA "EURO-ALBA.EA" SHPK  
PËRFAQËSUAR NGA Z. GAZMEN NËZA